



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 113, datë 06.06.2019

PËR

MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ Z. ZALO TOPÇIU

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 2) dhe pikës 21), të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 251, pika 3 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Byroja Shqiptare e Sigurimeve, me shkresën nr. 1192 prot. datë 18.02.2019, ka depozituar pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare një ankesë në lidhje me disa vlerësues dëmsh në sigurime, midis të cilëve edhe për z. Zalo Topçiu.

Nisur nga konstatimet e BSHS-së, dhe nga analiza e fakteve që Drejtoria e Zbatueshmërisë në bashkëpunim me Departamentin e Mbikëqyrjes (sektori i mbikëqyrjes së ndërmjetësve) ka bërë për shkeljet konkrete të këtij vlerësuesi të pavarur të dëmeve në sigurime, situata paraqitet si më poshtë:

Referuar kohës së hartimit të akteve, që kanë të bëjnë me rastin me paaftësi të përhershme të z. Aurel Hoti, si dhe rastin me pasojë vdekjen e të ndjerit z. Arben Xhemollari nga vlerësuesi i pavarur i dëmeve në sigurime z. Zalo Topçiu rezulton se aktet e vlerësimit për rastet e mësipërme, janë hartuar nga z. Zalo Topçiu, respektivisht në datat 15 nëntor 2018 dhe 4 dhjetor 2018.

Ndërkohë, Autoriteti, me Vendim Bordi, ka licencuar z. Zalo Topçiu me licencë nr. 75, me afat vlefshmërie nga data 30.01.2013-30.01.2018.

Pra siç rezulton, z. Zalo Topçiu ka ushtruar veprimtari si vlerësues dëmsh jashtë afatit të vlefshmërisë të parashikuar në licencë, në kundërshtim me nenin 226, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Procedura për marrjen e masës administrative, bazohet në Kodin e Procedurave Administrative, dhe në këto kushte AMF, ka njoftuar z. Zalo Topçiu, me shkresën nr. 910 datë 13.03.2019, për fillimin e procesit të marrjes së masës administrative.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Bazuar në pikën 3, germa c) të nenit 251, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të sanksionohet me gjobë në masën 200,000 lekë, z. Zalo Topçiu, për ushtrim veprimtarie si vlerësues dëmsh në kundërshtim me nenin 226, të këtij ligji.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI